

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST INFORMATION AND PRIVACY AGENCY	
ZYRA E ARKIVIT - KANCELARIJA ARHIVA - ARCHIVE OFFICE	
Njësia Org. Org. Unit	Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No. 268
Nr. Faqeve Br. Stranica No. of Pages 03	Data: Datum: Date: 10 05 2022

REPUBLIK E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE	
Njësia Org. Org. Jed.in. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 155
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages 03	Data Datum Date 10.05.2022
Prishtinë / a	



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
dhe
AKADEMISË SË DREJTËSISË**

**Neni 1
Qëllimi i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është përgatitur me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve të dy institucioneve në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok.

**Neni 2
Fushat e Bashkëpunimit**

Palët e lartcekura do të bashkërendojnë aktivitetet për afirmimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike përmes:

- Identifikimit të nevojave të zyrtarëve përgjegjës të sistemit gjyqësor dhe prokurorial rreth zbatimit praktik të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike;
- Formimit të grupit punues, përkatësisht ekspertëve dhe hartimit të modulit për Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, i cili do të ndihmojë zyrtarët përgjegjës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në menaxhimin e drejtë të regjistrave dhe të dhënave në përputhje me ligjet përkatëse;
- Mbështetjes profesionale, teknike dhe organizative në ofrimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përgjegjës të sistemit gjyqësor dhe

prokurorial për zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi për mbrojtën e të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike;

- Realizimin e aktiviteteve tjera me interes të përbashkët në këtë fushë. Përfshirjen e ekspertëve të AIP-së në grupe punuese; delegacione të institucioneve të gjyqësorit dhe prokurorisë në forume të brendshme, regjionale e ndërkombëtare, në rastet ku dy fushat që mbulon AIP janë temë diskutimi.

Neni 3

Analiza e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Palët do të shqyrtojnë në baza vjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas kësaj Marrëveshje. Sipas nevojës, palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e bashkëpunimit të kësaj Marrëveshje.

Neni 4

Dispozitat Përfundimtare

Bashkëpunimi bazohet vetëm në marrëveshjen, e cila synon ngritjen e kapaciteteve profesionale të profesionistëve ligjor të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe mbështetjen e tyre me ekspertizën e Agjencisë për Informim dhe Privatësisë në fushën e qasjes në dokumente publike dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Të dy institucionet do të emërojnë nga një pikë kontakti, përgjegjës për komunikim dhe koordinim të aktiviteteve të përbashkëta dhe për ta informuar njëra tjetrën në formë të shkruar.

Neni 5

Kohëzgjatja dhe Përfundimi

Secila palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje në tërësi apo pjesërisht me anë të njoftimit me shkrim ndaj palës tjetër, së paku një muaj më parë.

Secila palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje në tërësi apo pjesërisht në rast të ndonjë shkeljeje nga pala tjetër, duke i dhënë palës tjetër njoftim me shkrim për përfundimin e marrëveshjes.

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me nënshkrim të përfaqësuesve të autorizuar si më poshtë.

Neni 6
Gjuha e Përdorur

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit është përgatitur nga 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe serbe, për secilën palë nga një kopje në të dyja gjuhët.

Neni 7
Pëlqimi i Palëve



Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.

Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen me mirëkuptimin e palëve.

Neni 8
Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe do të vazhdojë deri sa palët nuk e ndërpretë atë.



Për: Agjencinë për Informim dhe Privatësi

Krenare Sogojeva- Dermaku

Komisionere për Informim dhe Privatësi

Për: Akademinë e Drejtësisë

Enver Fejzullahu

Drejtor i Akademisë së Drejtësisë

Nënshkruar më:10.05. 2022, në Prishtinë